



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0639

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) D D D SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Sherbimet e pastrimit te objekteve te mbrendshme dhe te jashtme DDD te objekteve shkollore - Qerdheve me numër të prokurimit 624-25-2877-2-1-1, me 01/09/2025,mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE D D D SH.P.K. me nr. 2025/0639, e datës 11/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Sherbimet e pastrimit te objekteve te mbrendshme dhe te jashtme DDD te objekteve shkollore - Qerdheve me numër të prokurimit 624-25-2877-2-1-1.
2. **Mbetet në fuqi**, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA SUHAREKË, lidhur me aktivitetin e prokurimit Sherbimet e pastrimit te objekteve te mbrendshme dhe te jashtme DDD te objekteve shkollore - Qerdheve me numër të prokurimit 624-25-2877-2-1-1.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik D D D SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.04.2025KOMUNA SUHAREKË,duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Sherbimet e pastrimit te objekteve te mbrendshme dhe te jashtme DDD te objekteve shkollore - Qerdheve me numër të prokurimit 624-25-2877-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 300,000.00 €.

Me 27.06.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin AK ka rekomanduar për kontratë GOE “Eko Lan Group SH.P.K. & MBUROYA SH.P.K.

Me 30.06.2025, OE D D D SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 04.07.2025.

Me 11.07.2025, OE D D D SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0639, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik D D D SH.P.K., lidhur me ankesën 0639/2025:

Ne, si GOE, në përputhje me Nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, paraqesim ANKESË ndaj vendimit të AK KK Suhareka për eliminimin tonë nga procedura e lartpërmendur, për arsyet e mëposhtme:

Pretendimi 1 – Kërkesa Nr. 5 në DT – Epidemiolog, Ekolog ose Biolog

Në vendimin e AK thuhet se: “Operatori Ekonomik ka ofruar dëshmi vetëm për një Epidemiolog dhe nuk ka sjellë Ekologun ose Biologun.” Ky interpretim është i gabuar, pasi që në DT kërkohet qartë: “Një Epidemiolog, Ekolog ose Biolog me përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit.”

Në ofertën tonë kemi dorëzuar: diplomën e epidemiologut, dëshminë për përvojën e punës mbi 5 vite pas diplomimit, CV të nënshkruar dhe kontratë/parakontratë specifike për projektin. Nga kjo, ne si GOE i përmbushim plotësisht kriteret minimale sipas terminologjisë “ose”, pa asnjë devijim nga DT. Çdo interpretim ndryshe i tejkalon kufijtë e tekstit të qartë dhe shkelë rëndë barazinë e konkurrencës.

Po ashtu, në vendimin e AK në Pretendimin 1 është një kontradiktë, citojmë: “GOE në fjalë ka sjellur vetëm epidemiologun dhe nuk ka sjellur ekologun apo biologun (biologu është sjellur në përmbushje të kërkesës nr. 7, pra si menaxher i kontratës dhe jo staf profesional siç kërkohet në kërkesën nr. 5). OE ka ofruar dëshminë: diplomën e noterizuar, CV-në e nënshkruar dhe kontratën e punës të nënshkruar.”

Në kontratën mes ekspertit dhe DDD SHPK theksohet saktësisht në Nenin 3: “Angazhim për punë të DDD-së në pozitën menaxher i projektit – biolog.” Bazuar në këtë përshkrim, biologu në këtë rast është edhe menaxher i projektit, si dhe njëherësh, bazuar në edukimin e tij profesional

dhe përvojën e punës (më shumë se sa është kërkuar në DT), është staf profesional dhe i mbikualifikuar bazuar në kërkesat në DT.

Pretendimi 2 – Kërkesa Nr. 7 e DT – Menaxheri i Kontratës (Biologu)

Sipas vendimit është theksuar që: “Kontrata e biologut nuk mbulon periudhën 36-mujore dhe kufizohet në 120 ditë pune brenda vitit.” Ne si GOE kemi dorëzuar kontratën ku:

Në Nenin 3 saktësohet periudha e angazhimit që mbulon tërësisht afatin 36-mujor të kontratës kornizë.

Në fakt, në kontratën e dorëzuar nga OE DDD SHPK dhe z. Daut Shabani, citojmë:

- Neni 3 i kontratës saktëson që angazhimi lidhet drejtpërdrejt me shërbimet për periudhën kohore që do të zgjasë projekti.

- Neni 4 i kontratës: shihet qartë se punëmarrësi e fillon punën në momentin kur të nënshkruhet kontrata nga OE me AK dhe jo siç ka interpretuar AK. “Punëmarrësi fillon punën pas nënshkrimit të kontratës me autoritetin kontraktues. Koha e propozuar është indikative, përderisa fillimi i angazhimit do të varet nga data e fillimit të punëve. Punëdhënësi do të njoftojë punëmarrësin së paku 7 ditë përpara fillimit të zbatimit për punë.” (të bashkangjitur gjeni kontratën)

- Neni 6 i kontratës konfirmon qartë: “Punëmarrësi në angazhim, për punët dhe detyrat e përcaktuara sipas Nenit 3 të kësaj kontrate, do të angazhohet pas nënshkrimit të kontratës deri në përfundim të projektit, gjithsej maksimumi 120 ditë gjatë një viti kalendarik.”

Ky formulim konfirmon qartë se kontrata hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet valide për të gjithë kohëzgjatjen e projektit, në përputhje të plotë me kontratën publike kornizë. Pra, pretendimi se kontrata nuk e mbulon periudhën e plotë është i gabuar, sepse periudha e vlefshmërisë ligjore është e qartë (37 muaj). Kontrata nuk përfundon automatikisht pas 120 ditëve, por zbatimi i punës kryhet sezonalisht brenda vitit, në përputhje me Ligjin e Punës (Neni 10 pika 6) dhe FTD. Kufizimi me 120 ditë pune brenda vitit është i parashikuar në Ligjin e Punës (Neni 10 pika 6), i cili lejon kontrata për detyra specifike me këtë kufizim të saktë. Shërbimet DDD kryhen me urdhra blerjeje, sipas FTD-së pika 5.4, gjë që e bën plotësisht të natyrshme menaxhimin e orëve të punës me fleksibilitet sezonal.

Për më tepër, në vendim theksohet se operatori nuk ka paraqitur biologun, por njëkohësisht analizohet kontrata e biologut. Kjo tregon kontradiktë: nuk mund të mungojë diçka që njëkohësisht gjykohet për vlefshmëri.

Pretendimi 3 – Eksperti i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Lidhur me kërkesën nr. 2 sipas FDT-së, grupi i operatorëve ekonomik ka ofruar kontratë për bashkëpunim me ekspertin për siguri dhe shëndet në punë, e cila nuk është në harmoni me kërkesën e autoritetit kontraktues pasi që e njëjta nuk ka të dhëna si: kohëzgjatja e kontratës (validiteti), numri personal i ekspertit, datëlindja, vendbanimi, shuma e pagës etj., si dhe autoritetit kontraktues i referohet si investitor.

Po ashtu, AK nuk e ka specifikuar në dosjen e tenderit se në kontratë duhet të ceket nr. personal, datëlindja, vendbanimi, shuma e pagës etj. Ne si GOE kemi ofruar kontratë bashkëpunimi mes

ekspertit Muhamet Hamiti dhe DDD SHPK, ku specifikohet qartazi emri i projektit, nr. i prokurimit dhe data e kësaj kontrate. Pretendimi i AK që kjo kontratë është për ndonjë investim nuk qëndron, pasi që në këtë kontratë tek përshkrimi “investitori” është drejtuar për AK, pra KK Suharekë, gjë që realisht është investitor në këtë projekt/aktivitet të prokurimit publik.

Po ashtu, në këtë kontratë është cekur se për detaje të këtij bashkëpunimi për këtë projekt mes ekspertit Muhamet Hamiti dhe DDD SHPK ekziston një parakontratë e cila i precizon të gjitha detajet si ato që AK i ka përshkruar në pretendimin nr. 3. Por prapëseprapë AK nuk e ka parë të arsyeshme të thirret në Nenin 59 të LPP-së. Autoriteti kontraktues është i obliguar të kërkojë sqarim me shkrim, për të verifikuar të dhënat, përpara se të marrë vendim eliminues. Thirrja në nenin 59 për sqarime nuk përbën ndryshim material, por një konfirmim procedural që e lejon ligji dhe njëherësh do të bëhej një vlerësim real i të gjitha ofertave dhe nuk do të paraqiste ndonjë dyshim për favorizim.

Mungesa e përputhshmërisë së lejes së importit me kërkesat e AK në DT për preparatet biocide

Grupi i operatorëve ekonomik që janë shpallur fitues kanë paraqitur lejen e importit me numër 25/526-38/-DDMU të datës 10.02.2025 lëshuar për OE Samire Osmani B.I. për import të produkteve biocide, ku kjo leje e importit nuk i plotëson kërkesat e DT të kërkuara në specifikimet teknike të detyrueshme Aneksi 1.

Kërkesa në Aneksin 1:

“- Preparatet repelente kundër insekteve në formë të granulave që nuk janë të rrezikshme për njerëzit dhe ambientet duhet të jenë me materie aktive natyrale, materie aktive si: Citronela, Allium sativum me sasi 100gr/m² – ekuivalente, si dhe duhet të kenë lejen për përdorim nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Preparatet në formë të granulave për largimin e zvarranikëve (gjarpërinjve).”

Bazuar në kërkesat e Aneksit 1 në DT, GOE i shpallur fitues në lejet zyrtare të importit siç janë:

Leja e importit me numër 25/526-38/-DDMU të datës 10.02.2025 e lëshuar për Samire Osmani B.I. dhe

Leja e importit me numër 24/2652-233/-DDMU të datës 08.05.2024 e lëshuar për Mburoya SHPK (e skaduar – duke ju referuar dokumentit zyrtar ku shkruan se leja e importit për produkte biocide lëshohet për periudhën njëvjeçare), të dorëzuara nga grupi i operatorëve ekonomik Eko Lan Group SHPK dhe Mburoya SHPK, rezulton se produktet biocide si: Citronella, Allium sativum dhe Cyming Ultra, të cilat janë të kërkuara në Aneksin 1, nuk janë në lejet e importit respektive dhe nuk ka preparate ekuivalente për këto produkte në lejet e cekura.

Në lejen e importit 25/526-38/-DDMU të datës 10.02.2025 e lëshuar për Samire Osmani B.I. figurojnë vetëm disa produkte. Pra, GOE nuk kanë ofruar ndonjë preparat tjetër i cili është ekuivalent dhe njëherësh i është lejuar importi, bazuar në kërkesat e AK në DT. Për sqarim me detaj, në lejet e importit të GOE të shpallur fitues nga AK nuk ka asnjë preparat i cili i përmbush kriteret bazike apo ekuivalente (ju lutem referojuni lejeve të importit të dorëzuara nga ana e GOE të shpallur fitues nga AK).

Pra, GOE-së i mungojnë preparatet repelente kundër insekteve në formë të granulave dhe preparatet për largim të zvarranikëve. Nëse bëni krahasimin e lejeve me GOE: DDD SHPK &

Doctor Exterminator DDD SHPK (të eliminuar), do të shihni dallimin, ku në rubrikën “Repellent” ekzistojnë produkte biocide të cilat përputhen me kërkesat e DT, Aneksi 1.

GOE: Eko Lan Group SHPK nuk ka ofruar leje të importit për produkte biocide; OE Mburoya SHPK ka ofruar leje të importit të skaduar; GOE kanë ofruar leje në emër të Samire Osmani B.I., i cili biznes në faqen e ARBK-së është i shuar dhe nuk mund të importojë produkte me këtë leje, bazuar në Ligjin për sistemin e lejeve dhe licencave 04/L-202, Neni 22, Neni 23, Neni 24 dhe Neni 25.

AK në këtë rast ka bërë shkelje ligjore duke shpallur GOE fitues edhe pse i njëjti GOE nuk i plotëson kërkesat e paraqitura në DT të AK-Komuna Suharekë.

Shkelje në barazinë në garë

Ne, si GOE, kemi ofruar preparate që janë në harmoni me kërkesat e DT dhe bashkangjitur me leje të vlefshme importi, duke garantuar gjurmueshmëri, përputhshmëri ligjore dhe siguri për ekzekutimin korrekt të kontratës. AK me të shpallur fituese ofertën e GOE të papërgjegjshme dhe me çmim më të lartë është në kundërshtim me kërkesat bazë të cilat vet AK i ka kërkuar dhe me këtë rast sipas mendimit tonë kanë bërë shkelje flagrante të dispozitave ligjore të LPP-së. Me këtë rast ne si GOE jemi të diskriminuar si në aspektin profesional ashtu edhe në atë ekonomik, pasi që është bërë një e padrejtë bazike ligjore.

Në bazë të të gjitha argumenteve të paraqitura, ju kërkojmë:

Anulimin e vendimit për dhënie të kontratës,

Rivlerësimin e ofertave,

Dhënien e kontratës ofertës tonë si oferta më e lirë dhe e përgjegjshme.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Grup i Operatorëve Ekonomik D D D SH.P.K.; DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K., rr. Ahmet Krasniqi, obj. Vicianum K-3, ARBERI, 10000, Prishtinë me adresë në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Shërbimet e pastrimit të objekteve të mbrendshme dhe të jashtme DDD të objekteve shkollore - Qerdheve me Numër të prokurimit: 624-25-2877-2-1-1 Numër i brendshëm: 624-25-14-211 kundër (NJOFTIM MBI VENDIM T'ls AK), të datës: 27.06.2025 të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 30.06.2025 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Refuzohet kërkesa për rishqyrtim sipas pretendimeve ankimore:

Pretendimi 1 – Nuk qëndron – Grupit të Operatorëve Ekonomik lidhur me kërkesën numër 5 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2 ka ofruar dëshmi vetëm për një Epidemiolog, dhe i mungon Ekolog ose Biolog. AK në mënyrë të qartë ka specifikuar kriteret në këtë pikë, pra ka kërkuar gjithësesi Epidemiolog duke vendosur presje (,) e pastaj e ka lënë mundësinë që Operatorët Ekonomik të sjellin edhe Ekologun ose Biologun për të plotësuar këtë kërkesë. GOE në fjalë ka sjellë vetëm Epidemiolog dhe nuk ka sjellë Ekologun ose Biologun

(Biologu është sjellë në përmbushje të kërkesës Nr. 7, pra si Menaxher i Kontratës dhe jo staf profesional sikur kërkohet në kërkesën nr. 5). Ky kriter nuk është plotësuar në plotëni nga GOE pasi që nuk ka ofruar dëshmitë për Ekolog ose Biolog fare sipas kërkesës Nr. 5 të dosjes së tenderit. Andaj GOE ka sjellë dëshmi të pamjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP-së, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik dhe profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Pretendimi 2 – Nuk qëndron – Tek neni 2 i kësaj kontrate marrëdhënia e punës është kufizuar që nuk mund të jetë më e gjatë se 120 ditë pune brenda vitit, andaj ky kufizim i kontratës bie ndesh me kërkesën numër 7 dhe seksionin e FTD-së pika 5.4 ku citohet: Dërgesat do të kryhen VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate publike kornizë. Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi. Gjithashtu kontrata e prezantuar për Biologun — Menaxheri i Kontratës (Daut Shabani) përkatësisht Neni 3 i kontratës ndër tjera parasheh periudhën kohore të angazhimit e cila sipas kontratës përfshin vitet 2025-2027. Sipas saj periudha e angazhimit nuk e plotëson kërkesën e AK për Kontratën Kornizë prej 36 muajsh. Ky kufizim i kontratës bie ndesh me kërkesën numër 7 dhe seksionin e FTD-së pika 5.4 ku citohet: Dërgesat do të kryhen VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate publike kornizë. Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi. Andaj, dëshmia e ofruar e kontratës për biologun lidhur me kërkesën numër 7 nuk është në harmoni me FTD. Për më shumë shih pjesën e kontratës si dhe përlllogaritjet e validitetit të kontratës në muaj.

Pretendimi 3 – Nuk qëndron – Lidhur me kërkesën numër 2 sipas FDT-së, Grupi i Operatorëve Ekonomik ka ofruar kontratë për bashkëpunim me ekspertin për siguri dhe shëndet në punë, e cila nuk është në harmoni me kërkesën e Autoritetit Kontraktues pasi që e njëjta nuk ka të dhëna si: kohëzgjatja e kontratës (validiteti), numri personal i ekspertit, ditëlindja, vendbanimi, shuma e pagës etj, si dhe autoritetit kontraktues i referohet si Investitor. Pra pretendimet tuaja se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP (Neni 59 paragrafi 2) nuk qëndrojnë sepse tek pretendim nr. 3 është keq interpretuar neni dhe paragrafi në fjalë. Andaj ky kriter nuk është plotësuar në plotëni sipas FDT-së ku është kërkuar kontratë pune ose parakontrata për këtë projekt.

Pretendimi 4 – Nuk qëndron – Lidhur me Ankesën numër 4 ju njoftojmë se ky kriter është plotësuar nga Lideri i Konsorciumit Eko Lan Group SH.P.K. Andaj kriteri në fjalë është në plotëni i plotësuar nga Lideri i Konsorciumit dhe pretendimi juaj ankimor nuk qëndron sepse tek pretendim nr. 4 është keq interpretuar nga ana juaj dhe nuk qëndron fare ky pretendim ankimor. Për më shumë shih Licencën përkatëse nga lideri i Konsorciumit. Për sqarimin tuaj AK këtë e mbështet edhe në RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK - Versioni i konsoliduar Rregullore Nr.002/2024 neni 26.5. Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzojë Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-së, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-së aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Andaj mbështetur nga elaborimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor refuzohet i pabazuar.

Pretendimi 5 – Nuk qëndron – Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME ju njoftojmë se ne si Autoritet Kontraktues kemi pranuar nga GOE fitues deklaratë mbi

përmbushjen e Specifikacionit Teknik të Detyrueshëm të nënshkruar dhe vulosur që ka qenë kriter në DT dhe FDT, pra ky kriter është plotësuar edhe sipas FDT dhe DT dhe po ashtu GOE fitues i ka bashkëngjitur këtë deklaram të nënshkruar dhe vulosur. Po ashtu kemi pranuar 5 punëtorë të certifikuar për të kryer këtë lloj shërbimi, ku GOE fitues e ka plotësuar në përpikëri edhe këtë kërkesë ku ka dorëzuar dëshmitë konform specifikacionit të kërkuar. Po ashtu Grupi i Operatorëve ka dorëzuar Lejën e Importit të lëshuar nga MMPHI-ja të datës 10.02.2025 me numër protokolli 526-2/25 e që kjo leje është valide në periudhë 1 vjeçare nga data e lëshimit. Pra Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues ka prezantuar preparate ekuivalente dhe për këtë ka bashkëngjitur edhe lejën përkatëse për përdorimin e këtyre produkteve nga MMPHI-ja. Për sqarimin tuaj ju njoftojmë GOE i rekomanduar fitues i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së të vendosura në Njoftim për Kontratë dhe DT ANEKSI 1. Andaj mbështetur nga elaborimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor refuzohet i pabazuar.

Detaje dhe argumente për pretendimet e neneve të shkelura dhe pikat ankimore për rishqyrtim të lartcekura nga OE, Autoriteti Kontraktues — Komuna Suharekë, konstaton se ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe nenet: Neni 1 Qëllimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo diskriminim, ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE ofertues në harmoni të plotë me Nenin 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve; Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë; Nenin 40 të Rregullores Nr.002/2024 për Prokurimin Publik, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve; Nenin 64 Dëshmitë e kërkesave; dhe në harmoni me LPP-në, Nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale dhe Nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës me kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE-të. Kriteri për dhënie të kontratës është oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë dhe mbi këtë bazë AK-Komuna Suharekë ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE-të në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0639, ndërsa me datë 16.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0639. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e

prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OED D D SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0639, ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Ankesa me nr. 2025/0639 është paraqitur nga GOE “DDD SH.P.K & Doctor Exterminator DDD SH.P.K” kundër Komunës së Suharekës, lidhur me vendimin për eliminimin e tyre dhe shpalljen e një GOE-je tjetër si fitues në tenderin për shërbime DDD. Ankuesi pretendon se ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, përfshirë ofrimin e një epidemiologu (siç kërkohej në dosjen e tenderit, me lidhëzën “ose” dhe jo të tre profesionistët), një kontratë të vlefshme për menaxherin e kontratës (biologun), si dhe një marrëveshje bashkëpunimi për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Gjithashtu, theksohet se GOE i shpallur fitues ka dorëzuar leje të pavlefshme importi për preparatet biocide dhe nuk i përmbush kërkesat teknike. Sipas ankuesit, AK ka shkelur parimet e barazisë, konkurrencës dhe të vlerësimit të drejtë. Kërkohej anulimi i vendimit dhe rivlerësimi i ofertave.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të paraqitura nga Grupi i Operatorëve Ekonomik “DDD SH.P.K & Doctor Exterminator DDD SH.P.K” kundër Komunës së Suharekës, për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e pastrimit të objekteve të brendshme dhe të jashtme DDD të objekteve shkollore – Qerdheve”. Pas shqyrtimit të dokumenteve të publikuara në platformën e prokurimit elektronik dhe përmbajtjes së ankesës, eksperti shqyrtues paraqet vlerësimet si më poshtë:

Pretendimi Ankimor Nr. 1

Ankuesi pretendon se në kërkesën Nr. 5 të Dosjes së Tenderit është përcaktuar:

“Një Epidemiolog, Ekolog ose Biolog me përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit.”

Sipas ankuesit, Autoriteti Kontraktues e ka interpretuar gabimisht këtë kërkesë duke pretenduar se duhej të dorëzoheshin dëshmi për më shumë se një profesionist.

Në vendimin e eliminimit thuhet se “Operatori Ekonomik ka ofruar dëshmi vetëm për një Epidemiolog dhe nuk ka sjellë Ekologun ose Biologun”.

Ankuesi thekson se interpretimi në vendimin e eliminimit se “Operatori Ekonomik ka ofruar dëshmi vetëm për një Epidemiolog dhe nuk ka sjellë Ekologun ose Biologun” nuk qëndron, pasi lidhëza “ose” në tekstin e DT-së qartë nënkupton alternativë, jo bashkëpërmbushje. Pra, është e mjaftueshme ofrimi i dëshmive për njërin prej tre profesioneve të përmendura.

Ankuesi sqaron gjithashtu se ka dorëzuar dokumentacion të plotë për një Epidemiolog, përfshirë diplomën, dëshminë për përvojë pune mbi 5 vite pas diplomimit, CV-në dhe kontratën përkatëse. Në këtë mënyrë, konsideron se i ka përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në DT.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1

Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga grupi i operatorëve ekonomikë “DDD SH.P.K & Doctor Exterminator DDD SH.P.K”, eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën e

përcaktuar në pikën 2 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional të Dosjes së Tenderit, e cila parasheh:

“Operatori Ekonomik duhet të ketë një Epidemiolog, Ekolog ose Biolog me përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit.”

Ankuesi ka dorëzuar dokumentacion të plotë për një Epidemiolog, përfshirë diplomën, dëshminë për përvojën e punës pas diplomimit, CV-në dhe kontratën përkatëse, pa u konstatuar mangësi në përmbajtjen e këtyre dokumenteve.

Megjithatë, nga shqyrtimi i të dhënave në platformën e-prokurimi rezulton se Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar ofertën me arsyetimin se “Operatori Ekonomik ka ofruar dëshmi vetëm për një Epidemiolog dhe nuk ka sjellë Ekologun ose Biologun”, duke interpretuar se kërkesa nënkuptonte përmbushjen e detyrueshme të më shumë se një profili profesional.

Një interpretim i tillë nuk gjen mbështetje në tekstin e Dosjes së Tenderit, i cili, përmes përdorimit të lidhëzës “ose”, parashtrohet në mënyrë të qartë karakterin alternativ të kërkesës – pra, është e mjaftueshme dorëzimi i dokumentacionit për njërin nga tre profilet e përmendura (Epidemiolog, Ekolog, ose Biolog). Kjo qasje përputhet me kuptimin e zakonshëm juridik dhe gjuhësor të fjalës “ose”.

Nuk është evidentuar asnjë sqarim apo ndryshim zyrtar që do të ndryshonte natyrën alternative të kërkesës. Çdo interpretim shtesë bie ndesh me dokumentacionin e tenderit dhe tejkalon kufijtë e vlerësimit të lejuar

Bazuar në sa më sipër, vendimi për eliminimin e ofertës nuk është në përputhje me:

Nenin 59.4 të LPP-së, i cili kërkon që tenderi të jetë në përputhje me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe të dosjes së tenderit;

Nenin 40.12 të Rregullores për Prokurim Publik, që ndalon diskualifikimin mbi baza të papërcaktuara më parë;

Nenin 40.13 të së njëjtës Rregullore, i cili detyron që vlerësimi të bëhet vetëm sipas kritereve të publikuara;

Nenin 7 të LPP-së, që garanton barazi dhe trajtim të drejtë të operatorëve ekonomikë gjatë procesit të vlerësimit.

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i paraqitur është i bazuar. Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën e operatorit ekonomik pa të drejtë, duke zbatuar një interpretim të gabuar dhe jo të mbështetur në dokumentacionin e tenderit.

Pretendimi Ankimor Nr. 2

OE ankues pretendon se në kërkesën Nr. 7 të Dosjes së Tenderit për Menaxherin e Kontratës, operatori ekonomik ankues “DDD SH.P.K & Doctor Exterminator DDD SH.P.K” kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues, i cili ka konstatuar se:

“Kontrata e Biologut nuk mbulon periudhën 36 muajsh dhe kufizohet në 120 ditë pune brenda vitit.”

Ankuesi sqaron se në kontratën e dorëzuar ndërmjet OE “DDD SH.P.K” dhe z. Daut Shabani, në:

Nenin 3 të kontratës është saktësuar se angazhimi lidhet drejtpërdrejt me kohëzgjatjen e projektit dhe se përfshin tërësisht periudhën 36-mujore të kontratës kornizë;

Nenin 4 parashihet që punëmarrësi të fillojë punën pas nënshkrimit të kontratës ndërmjet OE dhe Autoritetit Kontraktues, dhe se koha e angazhimit është e varur nga fillimi i punëve;

Nenin 6 thuhet qartë se punëmarrësi do të angazhohet deri në përfundim të projektit, me maksimum 120 ditë angazhim për çdo vit kalendarik.

Ankuesi thekson se kontrata është e vlefshme për të gjithë afatin e projektit dhe kufizimi me 120 ditë nuk përbën afat skadues të kontratës, por një mekanizëm për shpërndarjen sezonale të punës. Ky kufizim është i përcaktuar në përputhje me Nenin 10, pika 6 të Ligjit të Punës, i cili lejon kontrata për detyra specifike me kufizim vjetor të ditëve të punës.

Gjithashtu, theksohet se në dokumentacionin e ofertës është dorëzuar kontrata për Biologun, ndaj pretendimi se ai nuk është paraqitur bie në kundërshtim me faktin që kontrata e tij është analizuar nga Autoriteti Kontraktues.

Ankuesi konsideron se interpretimi i bërë nga Autoriteti Kontraktues është i gabuar dhe eliminimi i ofertës për këtë arsye nuk është i justifikuar.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e paraqitur nga operatori ekonomik ankues, i cili kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës lidhur me vlefshmërinë e kontratës së punës të dorëzuar për menaxherin e kontratës (Biologun).

Sipas kërkesës Nr. 7 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional në Dosjen e Tenderit, Operatorit Ekonomik i kërkohej të dorëzonte “kontratë pune ose parakontratë për një Biolog me përvojë pune minimale 3 vite në fushën përkatëse”. Në këtë kërkesë nuk specifikohet se kontrata duhet të mbulojë në mënyrë të vazhdueshme gjithë periudhën 36-mujore të kontratës kornizë.

Grupi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar kontratë me z. Daut Shabani, ku:

në nenin 3 dhe 6 parashikohet se angazhimi është i lidhur me kohëzgjatjen e projektit;

në nenin 4 thuhet se fillimi i punës varet nga nënshkrimi i kontratës me AK;

dhe në nenin 2 përcaktohet një maksimum prej 120 ditësh pune në vit, që lidhet me mënyrën e organizimit të punës, jo me skadimin e kontratës.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kontratës, rezulton se nuk ka kufizim kohor për vlefshmërinë e saj — ajo mbetet në fuqi për gjithë kohëzgjatjen e projektit, siç kërkohej në DT. Kufizimi me 120 ditë është në përputhje me nenin 10 pika 6 të Ligjit të Punës, i cili lejon marrëdhënie pune për detyra specifike me kohë të kufizuar vjetore.

Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktues ka zbatuar një standard të paformalizuar gjatë vlerësimit, duke tejkaluar kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Sipas nenit 59.4 të LPP-së,

një ofertë nuk mund të shpallet e papërgjegjshme nëse i përmbush kërkesat e njoftimit për kontratë dhe të dosjes së tenderit. Po ashtu, nenet 40.12 dhe 40.13 të Rregullores për Prokurim Publik ndalojnë diskualifikimin mbi baza të paformalizuara dhe kërkojnë që vlerësimi të bëhet vetëm mbi kriteret e publikuara.

Nëse AK ka pasur paqartësi për afatin e vlefshmërisë së kontratës, është dashur të kërkojë sqarime përmes nenit 59 të LPP-së, e jo të eliminojë ofertën pa e dhënë këtë mundësi.

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i paraqitur është i bazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 3

Grupi i operatorëve ekonomikë “DDD SH.P.K & Doctor Exterminator DDD SH.P.K” kundërshton arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kontratës së bashkëpunimit me ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke theksuar se:

AK ka konstatuar se kontrata e dorëzuar nuk është në harmoni me kërkesën Nr. 7 të Dosjes së Tenderit, për shkak të mungesës së elementeve si: kohëzgjatja, numri personal, datëlindja, vendbanimi dhe pagesa.

Sipas ankuesit, këto elemente nuk janë të specifikuar në Dosjen e Tenderit, prandaj nuk mund të kërkohej si kriter përjashtues.

Në kontratën e bashkëpunimit me ekspertin Muhamet Hamiti janë përfshirë emri i projektit, numri i prokurimit dhe data e kontratës.

Përshkrimi i "Investitorit" në kontratë i referohet Komunës së Suharekës, që realisht është investitor në këtë projekt, prandaj ky formulim nuk mund të përdoret si bazë për eliminim.

Po ashtu, kontrata e bashkëngjitur është mbështetur nga një parakontratë që përmban të gjitha detajet që përmend AK në arsyetim, dhe që vërteton qëllimin dhe përmbajtjen reale të angazhimit.

Ankuesi thekson se Autoriteti Kontraktues ka dështuar të kërkojë sqarime sipas nenit 59 të LPP-së, gjë që do të përbënte një procedurë të lejuar dhe të rregullt për konfirmimin e të dhënave dhe jo një ndryshim material.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 3

Në shqyrtim të pretendimit të paraqitur nga grupi i operatorëve ekonomikë “DDD SH.P.K & Doctor Exterminator DDD SH.P.K”, eksperti shqyrtues ka analizuar vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kontratës së bashkëpunimit me ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Sipas Kërkesës Nr. 2 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional në Dosjen e Tenderit, Operatorit Ekonomik i kërkohej të ofronte “kontratë pune ose parakontratë në emër të projektit me ofertuesin, për një Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë me përvojë pune minimale 5 vite”.

Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kontratën e ofruar me arsyetimin se ajo nuk përmban disa elemente si: datëlindja, vendbanimi, numri personal, kompensimi financiar dhe se në tekst përdoret termi “Investitor” për Autoritetin Kontraktues.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se kontrata e bashkëpunimit me ekspertin Muhamet Hamiti përmban:

Emrin e projektit dhe numrin e prokurimit;

Pozicionimin e ekspertit brenda projektit përkatës;

Përcaktimin e marrëdhënies së bashkëpunimit ndërmjet palëve;

Një deklaram të qartë që detajet e bashkëpunimit do të formalizohen në parakontratën që është në përgatitje.

Këto elemente janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën thelbësore të DT-së – domethënë, ekzistencën e një marrëveshjeje për angazhimin e ekspertit të sigurisë dhe shëndetit në punë. Asnjë nga elementet e cilësuara si mangësi nga AK nuk është kërkuar shprehimisht në dokumentacionin e tenderit. Për më tepër, përdorimi i termit “Investitor” për Komunën e Suharekës nuk cenon vlefshmërinë e marrëdhënies kontraktore, duke qenë se kjo komunë është autoriteti kontraktues dhe investitor në projekt.

Në këtë kontekst, Autoriteti Kontraktues është dashur, nëse kishte paqartësi lidhur me elementet e kontratës, të vepronte në përputhje me nenin 59 të LPP-së, duke kërkuar sqarime me shkrim nga operatori ekonomik, dhe jo të procedonte menjëherë me eliminim.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i paraqitur është i bazuar.

Pretendimi Ankimor Nr. 4

Operatori ekonomik ankues kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpalljen fitues të grupit të operatorëve ekonomikë EKO LAN GROUP SH.P.K. & MBROYA SH.P.K., duke pretenduar se:

GOE i shpallur fitues nuk ka ofruar preparate që i përmbushin kërkesat teknike të Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit, përkatësisht në aspektin e përbërjes, formës së aplikimit dhe lejimit për import. Sipas DT-së, është kërkuar që preparatet kundër insekteve të jenë repelente në formë granulash, të përmbajnë Citronella ose Allium sativum, dhe të kenë leje të vlefshme importi nga Ministria e Ambientit.

Leja e paraqitur për Samire Osmani B.I. nuk përfshin preparatet e kërkuara, as në aspektin e llojit të substancës aktive, formës së aplikimit (nuk janë granula), e as në aspektin e kategorizimit si repelent. Produktet e listuara në këtë leje janë insekticide, dezinfektues apo rodenticide, jo repelentë me përbërësit e kërkuar.

Leja tjetër, e paraqitur nga MBROYA SH.P.K., është e skaduar dhe nuk përmban preparatet që kërkohen me specifikimet e Aneksit 1.

GOE nuk ka ofruar dëshmi për vazhdimësi juridike dhe materiale nga biznesi individual Samire Osmani B.I. tek subjekti EKO LAN GROUP SH.P.K., në kuptim të transferimit të lejeve apo autorizimeve, siç parashihet me legjislacionin përkatës (Ligji për sistemin e lejeve dhe licencave 04/L-202 dhe Rregulloret përkatëse).

Në krahasim, operatorët tjerë konkurrues ankuesi pretendon se kanë ofruar produkte të llojit repelent në formën e kërkuar dhe me substanca aktive të përshtatshme, siç është rasti me preparatin “Granul alla citronella”, i cili përmban substancën Citronella dhe është lejuar për import nga MMPHI për një operator tjetër.

Ankuesi vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka shkelur parimin e barazisë dhe transparencës (neni 6 dhe 7 i LPP-së), si dhe ka diskriminuar ofertën e tij, e cila sipas tij ishte më e lirë dhe më përmbajtësore, në favor të një GOE-je që nuk i përmbushte kërkesat esenciale të tenderit.

Po ashtu, ankuesi pretendon se AK ka dështuar të kërkojë sqarime për dokumentacionin e dyshimtë të GOE-së përmes nenit 59 të LPP-së, veçanërisht në lidhje me vlefshmërinë e lejeve për subjektin EKO LAN GROUP SH.P.K.Në përfundim, ankuesi kërkon anulimin e vendimit për dhënie të kontratës, rivlerësimin e ofertave dhe dhënien e kontratës ofertës së tij si më e lira dhe më e përgjegjshme.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 4

Pretendimi ka të bëjë me ligjshmërinë dhe përputhshmërinë teknike të dokumentacionit të ofertës së grupit të shpallur fitues në raport me kërkesat e Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit për preparatet që do të përdoren në kuadër të shërbimeve të DDD-së në Komunën e Suharekës.

I. Përputhshmëria me specifikimet teknike të Aneksit 1

Sipas Aneksit 1 të DT-së, është kërkuar që preparatet repelente kundër insekteve të jenë:

në formë të granulave,

të përmbajnë Citronella ose Allium sativum në dozë 100gr/m² ose ekuivalente,

të jenë jo të rrezikshme për njerëzit dhe ambientin, dhe

të jenë të pajisura me leje përdorimi/importi të vlefshme nga Ministria përkatëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së grupit të shpallur fitues EKO LAN GROUP SH.P.K. & MBROYA SH.P.K., rezulton se janë paraqitur dy leje importi:

Leja nr. 25/526-38/-DMMU, datë 10.02.2025 për Samire Osmani B.I. – përfshin preparate si Aqua K-Othrine, Zinon EW, Solfac 050 EW, Perme Plus, Pyregreen, etj., të cilat janë insekticide dhe nuk përmbajnë Citronella apo Allium sativum, as nuk janë në formë granulash, dhe as nuk janë të kategorizuara si repelentë.

Leja nr. 24/2652-233/-DMMU, datë 08.05.2024 për MBROYA SH.P.K. – është e skaduar, dhe produktet e listuara në të nuk përputhen me specifikimet e Aneksit 1, as për nga përbërja, as për nga forma e aplikimit.

Gjithashtu, në dokumentacionin e ofertës nuk është ofruar deklaram për ekuivalencën e produkteve të propozuara me specifikimet teknike të kërkuara.

II. Mungesa e dokumentacionit ligjor për transferimin e lejeve

Subjekti EKO LAN GROUP SH.P.K. sipas certifatës së regjistrimit të biznesit, pjesë e dokumentacionit tenderik, është paraqitur si pasues i biznesit individual Samire Osmani B.I., megjithatë në dokumentacion nuk figuron ndonjë provë ligjore (si vendim nga autoriteti përkatës) që vërteton transferimin formal të lejeve apo autorizimeve nga subjekti i shuar te subjekti i ri.

Sipas nenit 25.15 të Rregullores për Prokurim Publik, anëtari i grupit që do të realizojë shërbimin duhet të jetë i pajisur me autorizim ose licencë të vlefshme përkatëse. Në këtë rast, EKO LAN GROUP SH.P.K., si bartës i pjesës së shërbimit (me 70% të pjesërrjes sipas marrëveshjes për themelimin të grupit), nuk ka paraqitur asnjë leje ose licencë në emër të vet (leja është në emër të biznesit të shuar Samire Osmani B.I), ndërsa leja e MBROYA SH.P.K. është skaduar dhe përmbajtja e saj nuk përputhet me kërkesat e Aneksit 1.

III. Mungesa e sqarimit paraprak

Në këtë situatë, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësinë që, në përputhje me nenin 59 të LPP-së, të kërkonte sqarime të mëtejshme nga grupi i shpallur fitues në lidhje me:

përbërjen dhe formën e preparateve të ofruara,

vlefshmërinë e lejeve,

dhe provat për vazhdimësinë ligjore midis subjekteve ekonomike.

Mungesa e këtij hapi procedural është në kundërshtim me frymën e nenit 59, i cili synon vlerësim të plotë, të drejtë dhe transparent të ofertave.

Mbështetur në të gjeturat e mësipërme, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik ankues është i pjesërisht i bazuar. Kjo vlerësim është dhënë për arsye se, ndonëse dokumentacioni i ofertës së grupit të shpallur fitues nuk përmbush kërkesat teknike të Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit në aspektin e përbërjes, formës së aplikimit dhe përmbajtjes së preparateve të kërkuara, Autoriteti Kontraktues nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të verifikuar vazhdimësinë ligjore ndërmjet biznesit individual “Samire Osmani B.I.” dhe subjektit “EKO LAN GROUP SH.P.K.”, në veçanti në raport me vlefshmërinë e lejes së importit të paraqitur.

Në këtë kontekst, mungesa e një sqarimi të formalizuar dhe të dokumentuar për kalimin e të drejtave dhe autorizimeve ndërmjet subjekteve ka krijuar pasiguri të theksuar mbi vlefshmërinë e dokumentacionit të ofertës, e cila duhej të ishte adresuar përmes nenit 59 të LPP-së, përpara marrjes së një vendimi për rekomandim kontrate.

PËRFUNDIM

Mbështetur në arsyet e lartcekura, eksperti shqyrtues propozon që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik me çmim më të lartë, për të cilin, nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore, rezulton se dokumentacioni nuk përmbush plotësisht kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve është konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me nenet 6 dhe 7 të LPP-së, ndërsa vlerësimi i ofertës nuk është realizuar në përputhje

me nenin 59.4 të LPP-së, si dhe me nenet 40.12, 40.13 dhe 25.11 të Rregullores për Prokurim Publik, në lidhje me vlefshmërinë dhe përputhshmërinë e dokumentacionit të ofertës.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues rekomandon kthimin e lëndës në rivlerësim, duke siguruar që procedura të zhvillohet në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores për Prokurim Publik.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertëve shqyrtues dhe mendimet e tij lidhur me këtë lëndë janë pjesërisht të pranueshme.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues përfshirë edhe përgjigjen e AK me mospajtim me raportin e ekspertizës.

Andaj, Paneli Shqyrtues do të lëshohet vetëm në pretendime ankimore të cilat janë përcaktuese për vendimmarrje në këtë lëndë dhe për të cilat nuk i ka mbështet përgjigjet e ekspertit shqyrtues. Pa nevojë që të përsëriten sërish të njëjtat.

Ankuesi në ankesën e tij, atakon AK se ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore me rastin e eliminimit të tij/saj nga kjo procedurë e prokurimit sa i përket asaj se Operatori Ekonomik ankues ka ofruar dëshmi vetëm për një Epidemiolog dhe nuk ka sjellë Ekologun ose Biologun. Paneli Shqyrtues duke u nisur nga kërkesa e Dosjes së Tenderit vërehet se kjo kërkesë e vendosur me nr. 5 tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale paska qenë shumë e qartë “*Kërkesa 5 - Operatori Ekonomik duhet te kete nje Epidemiolog, Ekolog ose Biolog. Me përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit*”. Kështu që, sipas Panelit shqyrtues kërkesa në DT paska qenë që Operatori pjesëmarrës duhet ta ketë 2 veta (persona) patjetër një epidemiolog dhe një Ekolog i cili mund të zëvendësohet me një Biolog. Sikurse të kishte qenë kërkesa e DT që Operatori Ekonomik duhet te kete nje Epidemiolog ose Ekolog ose Biolog, atëherë, kishte me qenë situatë krejt ndryshe dhe OE ankues do të kishte të drejtë ta atakojë. Por, përderisa janë kërkuar epidemiolog dhe ekolog ose biolog dhe ankuesi ka sjellë vetëm epidemiolog dhe jo ekologun apo biologun sipas kërkesë së DT nr. 5, atëherë OE ankues nuk e plotëson kërkesën e DT dhe për këtë ankuesi për çdo paqartësi ka pasur mundësi që konform nenit 53 të LPP të kërkoj sqarime para ofertimit.

Ankuesi në ankesën e tij, atakon AK se ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore edhe sa i përket përzgjedhjes së OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues nuk e mbështet aspak përgjigjen e ekspertit shqyrtues i cili nuk ka shfletuar të gjithë dokumentacionin sepse faqen e dytë të certifikatës së regjistrimit është shënimi:

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
812244838

Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak

; Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 71217574, me zbatimin e ligjit për numrin unik të identifikues të biznesit ka këtë numër NUI: 811044247 Biznesi individual me emër Samire Osmani B.I. dhe emër tregtar 'Eko Pastrimi DDD' themeluar me 13/11/2015 si Biznes Individual me numër unik identifikues 811044247 dhe numër të biznesit 71217574. Me datën: 05-02-2025 ky biznes e ndrron tipin në 'Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar' me emër të biznesit Eko Lan Group SH.P.K. dhe merr numër të ri të biznesit 812244838 dhe është vazhdim i biznesit të mëhershëm.

Po ashtu, Paneli shqyrtues thekson se lidhur me specifikimet teknike AK në refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim ka japur sqarime se OE i rekomanduar ka ofertuar konform specifikimeve teknike të DT dhe Grupi i Operatorëve ka dorzuar Lejën e Importit të lëshuar nga MMPH-ja të datës 10.02.2025 me numër protokollit 526-2/25 e që kjo Leje është valide në periudhë 1 vjeqare nga data e lëshimit pra Grupi I Operatorëve Ekonomike fitues ka prezentuar preparate ekuivalente dhe për këtë ka bashkëangjitur edhe Lejën përkatëse për përdorimin e këtyre produkteve nga MMPH-ja.

Andaj, Paneli Shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe përgjigjen e AK të dhënë karshi raportit të ekspertizës, vlerëson se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e pjesërisht e bazuar. por e cila është e pamjaftueshme që të anuloi vendimin e AK. Paneli Shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik konkretisht nenit 59 dhe 60 të LPP dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Sherbimet e pastrimit të objekteve të mbrendshme dhe të jashtme DDD të objekteve shkollore - Qerdheve me numër të prokurimit 624-25-2877-2-1-1.

Paneli Shqyrtues vlerëson se AK duke u bazuar në nenet 59 dhe 60 të LPP ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”, atëherë bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e

AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Andaj në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosë po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në nenin 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji"

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - D D D SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: